

**Rritje të tërheqjes së rajoneve rurale
në Rajonin e Vardarit:
Zhvillmi i fushës së certifikuar f. Begnishtë**

RRUGA E RRUSHIT ORGANIK



BIOVITA – EKOVITA

Rajoni i Vardarit

2019

HYRJE

Nevoja në rritje për ushqim ka sjellë zhvillimin e bujqësisë kryesisht duke u mbështetur në përdorimi në lëndëve kimike dhe mekanizimit. Përdorimi i tepërt, i pakontrolluar, shpeshtë dhe joprofesional i lëndëve kimike (plehra dhe lëndë për mbrojtjen e bimëve) në prodhimtarinë konvencionale, me qëllim të realizimit të rendimentit dhe përfitimit më të lartë, ka shkaktuar ulje të cilësisë dhe pjellshmërisë së tokës. Përveç kësaj, shpesh injorohet cilësia dhe siguria e ushqimit për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve, si dhe parimet kryesore për mbrojtje të sistemit ekologjik dhe bujqësor.

Prodhimtaria organike në mënyrë efikase zgjedh këto probleme, sepse ofron një mënyrë më humane të prodhimtarisë së ushqimit, në plan të parë vendos shëndetin e njeriut dhe respekton baraspeshën natyrore ekologjike, duke shmangur ndotjen e mjedisit. Prodhimtaria organike është orientuar drejt ardhmërisë dhe zhvillimit të mëtutjeshëm, jo vetëm në kuptim të mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe avancimit të shëndetit të njerëzve, por edhe në aspekt të prosperitetit ekonomik. Prodhimtaria organike e ushqimit bazohet në kontrollin biologjik dhe largimin e lëndëve të dëmshme kimike. Ajo do të thotë dhe të shëndoshë, farë që nuk është trajtuar me lëndë kimike, ujitje me ujë të pastër dhe ndalesë e përdorimit të mjeteve sintetike për spërkatje nga njëra anë dhe përdorimi i llojeve të adaptuara autoktone të bimëve dhe kafshëve, promovim të armiqve natyror të sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe përdorimi i lëndëve të padëmshme natyrore për mbrojtje.

Në rajonin e Vardarit, prodhimtaria e rrushit është më e përfaqësuar, por në periudhën e fundit, për shkak të rentabilitetit të dobët dhe problemet me blerjen, një numër i prodhuesve kanë braktisur dhe kanë vendosur të merren me diçka tjetër ose kërkojnë mundësi për të fituar jashtë rajonit ose vendit. Përveç disa aktiviteteve kulturore në qytetet më të mëdha (Kavadar dhe Negotinë), në rajonet rurale aspak nuk është zhvilluar turizmi lokal rural, që mes tjerash, do të kontribuojë për ofertën më të llojllojshme dhe do të ofrojë impuls plotësues në bujqësi dhe mundësitë për zhvillim të veprimtarive të reja.

Prodhimtaria organike është një prej shtytësve për rritjen e tërheqjes së mjediseve rurale. Në këtë dokument të shkurtë kemi prezantuar konceptin e zhvillimit progresiv të prodhimtarisë me anë të certifikimit të kapaciteteve prodhuese në rajonin për f. Begnishtë, me theks të hardhive të rrushit. Kjo ide përfshin nxitje të prodhimtarisë organike, kryesisht të rrushit për verë, si produkt primar bujqësor – material përpunues për verë organike (posaçërisht nga lloji Stanushinë, si autentike për këtë rajon) dhe produkte tjera organike, dhe me atë edhe zhvillim të ekonomisë lokale me anë të turizmit me aktivitete të reja kulturore dhe llojllojshmëri lidhur me rrugën e rrushit organik.

ZBULIME KRYESORE

Fshati Begnishtë gjendet në pjesën jugore të Kavadarit në fushën e lartë Vitaçevë, ndërsa territori i fshatit shtrihet deri në liqenin artificial të Tikveshit. Fshati gjendet ë kodër dhe është në 400 m në lartësi mbidetare. Nga qyteti, fshati gjendet në distancë prej 11 kilometrave dhe në fshat arrihet me anë të rrugës me asfalt. Territori i f. Begnishtë përfshin hapësirë prej 14.7 km². Kryesisht gjenden kullosa në sipërfaqe prej 727.6 hektarë, tokë punuese është rreth 500 hektarë, ndërsa pyje 134 hektarë (E-kadastër i RM, 2018).

f. Begnishtë përbën një fshat të llojit të dendur dhe është ndarë në shtatë lagje. Në anën e majtë të fushës gjendet Lagjia Grizhevsko që është pak e shpërndarë. Në anën e djathtë gjenden lagjet tjera të dendura. Në rrugën kryesore është mesi i fshatit me shkollën, pallatin e komunës, kafeterinë dhe dhjetëra dyqane dhe artizanë. Kisha gjendet nën Lagjen Trençev. Lagjet tjera janë Rogovo, Daskallovë, Gjorqevë, Spanxhak dhe Tasevë. Fshati ka dy kisha dhe në afërsi të fshatit gjendet një kishë në shpellë nga mesjeta “Shën Lazari”, e njohur edhe si kisha Spoishka. Kisha është një përmendore e rëndësishme arkitektonike me freska të ruajtura nga shekulli XIV.

f. Begnishtë është fshat i madhësisë së mesme. Sipas regjistrimit të fundit (ESHS, 2002), në fshatin Begnishtë ka pasur 369 banorë. Një e dhënë tjetër që mund të përdoret është informacioni që në zgjedhjet lokale të vitit 2017 në këtë vendvotim janë të regjistruar gjithsej 278 votues. Në fshat ka 120 shtëpi prej të cilëve 80 janë të banuara, ndërsa 40 përdoren prej kohe në kohë nga persona që kanë hardhi ose i përdorin si shtëpi çlodhjeje. Për f. Begnishtë, përveç vreshtarisë, një shenjë tjetër është grupi Xhollomarë – një zakon pagan që festohet më 14 janar (Vasilicë), kur banorët e fshatit me tradita të posaçme i largojnë shpirtrat e këqij. Përveç largimit të shpirtrave, Xhollomarët luajnë edhe për vit të frytshëm.

Mikro-klima është shprehur me verë të thatë dhe të gjatë, me të reshura prej 350 deri 450 mm në vit, por mëngjeset e freskëta me praninë e erës së dobët e bëjnë këtë lokacion një prej më të volitshme për prodhimtarinë e rrushit për verë, më pak në sasi, por me cilësi të jashtëzakonshëm. Të mbjellat me hardhi gjenden në 300 deri 480 lmd, që e bëjnë këtë vend ideal për fitimin e relacionit harmonik të sheqerit dhe acideve të verës.

Në territorin e f. Begnishtë ka rreth 180 ha hardhi rrushi (E-kadastër i RM, 2018). Me anë të bisedave me prodhuesit e rrushit, kemi mësuar që në momentin për shkak të rendimentit të ultë të hardhive, mungesa e vendosjes së rrushit dhe mos pagesa me kohë, shpërndarja e parcelave, mungesa e sistemit të ujitjes, si dhe fuqia e dobët ekonomike e prodhuesve, kemi braktisje masive të vreshtarisë si veprimtari dhe migracion të vreshtarëve në Kavadar ose jashtë shtetit.

Nga hulumtimet dhe anketat e zhvilluara me banorët e fshatit dhe komunitetin lokal, kemi konstatuar që në territorin e f. Begnishtë kultivohet në mënyrë që është më afër asaj tradicionale, dhe ka prodhues që për momentin mbrojtjen dhe plehun e bëjnë në mënyrë që paraqet respektim të rregullave për prodhimtari organike. Gjithashtu, kemi konstatuar që shkalla e informimit të prodhuesve të rrushit për prodhimtari organike është në nivelin më të lartë, dhe fakt për këtë është që deri tani nuk ka asnjë prodhues që posedon certifikatë për prodhimtari organike (Regjistri i Prodhuësve Organik, MBPEU, 2018). Interesant është fakti që në f. Begnishtë lloji autokton i erës Stanushinë është e përfaqësuar në përqindje të lartë në krahasim me komunat tjera në të cilat kultivohet hardhi rrushi.

Prodhimtaria për ekzistencë dhe mundësia e prodhimit në sasi më të vogla, si dhe kultivimi i Stanushinës si lloj që është autokton dhe rezistues ndaj sëmundjeve, janë në dobi që në territorin e f. Begnishtë ka potencial të lartë për zhvillim të prodhimit organik në tërësi. Në afërsi nuk ka kapacitete industriale, deponi, rrugë frekvente, etj., që si ndotës eventual do të mund të përjashtojnë rajonin si të pavalitshme për organizimin e prodhimit organik. Certifikimi i hardhive të rrushit drejt do të ndikojnë mbi përdorimin më të lartë të kapaciteteve të përpunimit sepse në rajonin e Tikveshit ka nevojë për rrush organik për prodhimtari të verës, maxhun dhe pije tjera joalkoolike. Gjithashtu, rentabiliteti i prodhimit mund të rritet me atë që konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë çmime më të larta për këto prodhime.

Në pjesën e certifikimit, fshati Begnishtë është interesante edhe me atë që në disa hardhi, që janë më të vjetër se 40 vite, me distancë të parregullt për përdorimin e traktorit për lëvrim dhe mbrojtje të hardhive, që gjatë kultivimit përdoret bagëtia, ndërsa mbrojtja bëhet me anë të spërkatëses në shpinë dhe me çorbë borde dhe sulfur. Kjo teknikë e kultivimit të hardhive të rrushit jep mundësi për shkurtim të periudhës së tejkalimit dhe fitimit të statusit organik që në vitin e parë. Për dallim nga kjo situatë, kalimi nga hardhi klasik konvencional në atë organik kërkon respektim të rregullave për prodhimtari organikë në afat prej 3 viteve, pas së cilës vijon statusi i prodhuesit organik.

Një nxitje plotësuese të prodhimit organikë është mbështetja financiare nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për hardhi të certifikuar organikë. Gjithashtu, ka masë për mbështetje të një pjese të shpenzimeve për certifikim. Përveç këtyre masave, kyçja dhe zhvillimi i kulturës dhe turizmit në territorin e f. Begnishtë mund të realizohet me masa të ndryshme që kanë të bëjnë me turizmin rural dhe llojlojshmërinë në kuadër të fondeve kombëtare dhe IPARD2.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

I gjithë koncepti mund të fillojë me **certifikimin e disa prodhuesve** që me certifikatat e tyre prodhueset përputhen parimeve të vreshtarisë organikë he do të shërbejnë si shembull i suksesshëm për vreshtarët tjerë. Territori i f. Begnishtë mund të ndahet në 5 njësi të pavarura, prej të cilëve tërësisht do të certifikoheshin pjesët në lartësi më të lartë mbidetare, dhe në periudhë prej 5 viteve të përfundojë gjithë procesi.

Faktor kryesor i rrezikut paraqet interesimi i vreshtarëve të orientohen drejt praktikave të prodhimit organikë. Andaj, për të arritur realizimin e idesë, duhet **informim dhe edukim** i vreshtarëve dhe popullatës lokale. Duhet të gjendet mënyrë që të bindet prodhuesit dhe pranojnë mënyrën organikë të vreshtarisë. E njëjta mund të arrihet edhe me angazhimin e personave profesional të kësaj fushe. Për fillim, një numër i vogël i prodhuesve do të jenë të mjaftueshëm për shembull, në çfarë mënyre me pak ose të njëjtë sasi mund të fitohet prodhimtari me vlerë të shtuar, dhe me anë të certifikimit mund të shitet me çmim më të lartë.

Me rëndësi është këtu të inkurajohen prodhuesit dhe popullata lokale për përdorimin e **masave për mbështetje të bujqësisë dhe zhvillimit rural**.

Bartës të idesë janë BIOVITA dhe EKOVIDA që bashkë me shoqatat lokale do të realizojnë **festivalin e ushqimit organik "Begnishtë Organike"**, që do të mbahej më 21 shtator, kur në fshat ka atmosferë festimi dhe festohet festa fetare Mala Bogorodica. Në vetë festivalin do të

inkurajohet shitja e produkteve lokale dhe përpunimeve organike, si dhe lloje të ndryshme të ushqimit dhe punime tipike për këtë rajon. Në festivalin e ushqimit organik **"Begnishtë Organike"**

Në aspekt të **zhvillimi ekonomik lokal dhe turizmit** "Begnishtë Organike", në kombinim me festimin autentik të Vitit të Ri të Vjetër dhe afërsia e Liqenit të Tikveshit, si resurse, paraqet një koncept origjinal dhe bazë për krijimin e përmbajtjeve tjera që mund të tërheqin turistë nga vendi dhe bota.

Drejtimet dhe rekomandimet kryesore janë të përmbledhura më poshtë:

- të nxitet prodhimtaria organike
 - të mundësohet informim më i gjerë për prodhimtarinë organike
 - të sigurohen trajnime përkatëse dhe ndihmë nga ekspertë
 - resurse për promovim – mendimi për marketing qasjen, nevoja për hulumtim të tregut
 - Koncepti, përveç i prodhimit të rrushit organik dhe përpunimeve, mund të zgjerohet edhe në kultura tjera (pa gluten dhe tjera)
 - territori të certifikohet, projekti i parë i këtij lloji
- të promovohet blerja e rrushit organik dhe mënyra të reja të prodhimtarisë dhe shitjes
 - nxitje të blerjes së rrushit organik
 - hapje të kanaleve për shitje të drejtpërdrejtë
 - Nxitja e llojeve më të gjera të produkteve dhe organike dhe përpunime (verë, raki, maxhun, ëmbëlsira me reçel, produkte tradicionale, përpunime të ndryshme qumështore - djathë dhe kaçkavall, produkte të reja inovative)
- Të lidhet prodhimtaria organike me zhvillimin ekonomik lokal dhe zhvillimin e turizmit
 - Organizimi i festivalit të ushqimit dhe verës organike "Begnishtë Organike"
 - Lidhje me traditën lokale "Xholomlarë" për Vitin e Ri të Vjetër
 - Hulumtimi i mundësive për sigurim të kapaciteteve rurale të akomodimit
 - Sigurimi i vendeve me sipërfaqe në RM dhe të jepen investitorëve potencial që të vreshtarëve që do të prodhojnë verë dhe produkte tjera organike

KONKLuzion

Parcelat e vogla dhe të shpërndara, pjellshmëria e dobët e vreshtarve, mungesa e sistemit të ujitjes si dhe fuqia e dobët ekonomike e vreshtarëve janë mungesa gjatë prodhimtarisë konvencionale që i bën vreshtarët e f. Begnishtë jo konkurrues në krahasim me vreshtarët nga pjesët më të ultë të rajonit të Tikveshit. Këto mungesa janë të kombinuara, ashtu që, për prodhimtarinë organike paraqesin përparësi, dhe përdorimi i tyre mund të kontribuojë në ngjalljen e ekonomisë lokale në shumë baza.

Territori i Begnishtë është përkatëse për vreshtari të gjerë, përshtatshme për ndryshim në prodhimtari organike. Ky transferim mund të përdoret për të nxitur tërheqjen e këtij territori, me ofertë të re të ngjarjeve kulturore dhe festivaleve dhe lidhje me traditën. Fermerët do të nxitin për prodhimtarinë e recetave të vjetra të produkteve me rrush (verë, raki, maxhun, ëmbëlsirë me reçel), si dhe zhvillim të produkteve të reja inovative nga rrushi.

Me anë të efektit të historisë së suksesshme, **Begnishtë Organike** mund të zbatohet edhe në rajone tjera si model që bashkërisht janë të përfshirë fermerët, tradita dhe rrethina. Pas realizimit të projektit mund i njëjti të kopjohet edhe në fshatrat përreth të Resavës, Dabnishtë dhe Koshan dhe në atë mënyrë të krijohet një fushë më e gjerë e certifikuar, që do të bëhet një qendër e njohur për prodhimtari organike të verës dhe produkteve tjera organike nga rrushi, si bazë për zhvillim të turizmit lokal. Si plotësim vije edhe informacioni që në periudhën 1952-1955. fshati ka qenë seli e komunës së atëhershme Begnishtë, që përveç fshatit Begnishtë, kanë qenë edhe fshatrat Granikovë, Dabnishtë, Dragozhel, Kazhan, Kumaniçevë dhe Resavë. Ky grup i fshatrave janë ideale për rajone organike, nëse ka ambicie për më tutje.

BURIMET

Vikipedi, enciklopedia e lirë (internet, 2018)

ESHS (2002) Regjistrimi i Popullatës, Amvisërive dhe Vendbanimeve në Republikën e Maqedonisë. Libri X. Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë, Shkup.

E-kadastër i RM (internet, 2018) www.katastar.gov.mk

MBPEU (2018) Regjistri i Prodhuesve Organik, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit e Republikës së Maqedonisë.

Dioqeza e Vardarisë (internet, 2018) www.povardarska-eparhija.org.mk

biovita

Shoqata e prodhuesve të ushqimit organik "Biovita" – Kavadar

Kryetar, Cvetanka Koleva

078 237 130

biovitaorganic@gmail.com

<http://biovitaorganic.blogspot.com/>



Shoqata e Qytetarëve "Ekovita" – Negotinë

Kryetar, Sashko Todorov

070 684 036

ekovita@hotmail.com

www.ekovita.mk

<https://www.facebook.com/profile.php?id=100009539103916>

www.ekovita.blogspot.com

Aktivitetet aktuale 2018

- Në rrjedhë është realizimi i projektit "**Të drejtë ndaj natyrës**" në të cilin partneri kryesor është OJQ Ekovita, Negotinë, ndërsa ZOPH "Biovita", Kavadar është bashkë-partner. Projekti është aprovuar nga "Parlamenti Rural Kombëtar".
- Në rrjedhë është realizimi i projektit "**Jep për shtëpi të sigurt dhe rrethinë të sigurt**", i aprovuar nga Fondacioni "Konekt", në të cilin anëtarë të ZPOH "Biovita" nga Kavadari bashkë me partnerin OJQ "Ekovita" nga Negotina do të marrin pjesë aktive në aktivitetet e projektit.

